



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën d. Nenit 40 paragrafi 2 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 3, dhe 16 pika 7 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IX-të të rregullt, të mbajtur më 30.10.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për vënien në diskutim publik

Të Ndryshimeve dhe Plotësimeve të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale dhe Projekt-Rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

I

Miratohet Vendimi për vënien në diskutim publik të Ndryshimeve dhe Plotësimeve të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale si dhe Projekt-rregullores për Tatimin në Pronën e paluajtshme.

II

Aktet si në pikën 1 të këtij Vendimi lëshohen në Diskutim Publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin të dhëna, po ashtu të bëjnë vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim ku mund t'i dorëzojnë tek Zyra ligjore në objektin e Komunës.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio- "ALBA".

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-5669 /2015
Klinë, më 09.11. /2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi